



Tempus Hemma WEBB - Për ju si kujdestarë

- Hapni faqen elektronike dhe shkoni tek www.tempushemma.se
- Zgjidhni zonën "Helsingborg"
- Zgjidhni veprimtarinë "Qyteti Helsingborg"
- Klikoni në kutinë e gjelbër Helsingborg BankID dhe identifikohuni me BankID tuaj. Nëse nuk keni BankID, kontaktoni parashkollorin.

Planifikoni/Raportoni pushimin/lejen

- Kur jeni identifikuar, ju shihni informacione për fëmijën tuaj, veprimtaritë kalendarike dhe orarin ditor.
- Klikoni në skedën "Orari/leje".
- Plotësoni oraret për javën që dëshironi të raportoni duke klikuar në kutitë poshtë *çdo dite*. Nëse fëmija juaj është i lirë, klikoni në kuti. Gjithçka ruhet automatikisht.
 - Kur klikoni në një ditë, ka mundësi për të dhënë informacion shtesë ose informacion për një kujdestar tjetër.
 - Dëshironi të keni të njëjtën orar për disa javë ose për disa fëmijë, klikoni *kopjo midis fëmijëve/javëve* pikërisht mbi javën e raportuar.
 - Kopjo tek një fëmijë tjetër: Zgjidhni fëmijën në të cilin dëshironi të kopjoni dhe shënoni për cilat javë. Klikoni *kopjo midis fëmijëve*.
 - Kopjo për disa javë: Shënoni vetëm në cilat javë dëshironi të kopjoni. Klikoni *kopjo për javë*.

Raportoni mungesën

- Klikoni në skedën **Raporto mungesën** nëse fëmija juaj duhet të qëndrojë në shtëpi për kujdes shëndetsor.
- Zgjidhni fëmijën tuaj.
- Zgjidhni datën e aplikimit në kalendar.
- Zgjidhni një pjesë të ditës ose gjithë ditën.
- Jepni pëlqimin që informacioni të ruhet në Tempus nëse kërkohet.
- Klikoni butonin **Raporto mungesën**.

Dallimi midis pushimit/lejes dhe mungesës

Pushimi/leja duhet të raportohet kur fëmija nuk ka nevojë të jetë në parashkollor p.sh. nëse dikush tjetër do të kujdeset për fëmijën ose nëse familja shkon me pushime.

Mungesa është kur fëmija është planifikuar të jetë në parashkollor por nuk mund të vijojë për shkak p.sh. vizita te mjeku ose sëmundje.



Njoftimi për mungesë përmes UnikumFamily

Nëse fëmija juaj është i sëmurë, është e rëndësishme të njoftoni parashkollorin. Mënyra më e lehtë për ta bërë këtë është nëpërmjet aplikacionit Unikum Familj, ku mund të ndiqni edhe dokumentacionin e fëmijës suaj.

Klikoni në raportimin e mungesës dhe zgjidhni fëmijën që dëshironi të raportoni mungesën. Shënoni ditët kur fëmija juaj është i sëmurë dhe klikoni "raporto". Tani parashkollori merr një njoftim që fëmija juaj është raportuar që mungon.